



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË

№ 223 Prot.

Datë 28 / 3 / 2025

**RREGULLORE E BRENDSHME
E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT
TË
QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË**

KRYETARI

EDOL CASHKU



KREU - I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	2
A.QËLLIMI	2
B.BAZA LIGJORE	2
KREU - II- STRUKTURAT PËRBËRËSE	2
A. KËSHILLAT DHE KOMISIONET	2
A.1 KËSHILLAT E MIRATIMIT TË PROJEKTEVE	2
A.1.1 KRIJIMI I KMP-ve DHE PËRBËRJA E TYRE	3
A.1.2 FUNKSIONIMI I KMP-ve	3
A.1.3 SEZONI I THIRRJEVE PËR APLIKIME/PROJEKTE	5
A.1.4 PROCESI I VOTIMIT	5
A.1.5 TË DREJTAT E ANËTARIT TË KMP	6
A.1.6 DETYRAT E ANËTARIT/ES TË KMP	6
A.1.7 PËRFUNDIMI I PARAKOHSHËM I MANDATIT	7
A.2 KOMISIONI I SHQYRTIMIT PARAPRAK TË PROJEKTEVE	7
A.3 KOMISIONI I MONITORIMIT TË PROJEKTEVE	8
A.4 KOMISIONI FINANCIAR	10
A.5 KOMISIONI I VIZIONIMIT	10
B. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I PERSONELIT	12
B.1 DETYRA TË PËRGJITHSHME	12
B.2 STRUKTURA E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË PERSONELIT	12
B.2.1 KRYETARI	13
B.2.2 DREJTORIA E PROJEKTEVE	14
B.2.2.1 DREJTORI I DREJTORISË SË PROJEKTEVE	14
B.2.2.2 SPECIALIST JURIST	15
B.2.2.3 SPECIALIST I PROJEKTEVE	16
B.2.2.4 SPECIALIST PËR MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE SHTYPIN	16
B.2.2.5 ARKIVIST	17
B.2.3 SEKTORI I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME	18
B.2.3.1 PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE TË BRENDSHME	18
B.2.3.2 SPECIALIST-INSPEKTOR PER PROJEKTET, MENAXHER	19
B.2.3.3 SPECIALIST MBËSHTETËS	19
KREU - III- BULETINI ZYRTAR I KINEMATOGRAFIKË	20
KREU - IV- HYRJA NË FUQI	20

E.Ç.

KREU - I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

A. QËLLIMI

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe funksionimit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, duke përcaktuar rregullat mbi krijimin dhe funksionimin e Këshillave të Miratimit të Projekteve, komisioneve të tjera që funksionojnë brenda dhe pranë QKK-së, strukturat e brendshme të saj duke përcaktuar edhe detyrat përkatëse.

QKK bashkëpunon me organizata dhe institucione ndërkombëtare për të lehtësuar koproduksionet kinematografike, në përputhje me Konventën Evropiane për Koproduksionet Kinematografike dhe rregullat e ndihmës shtetërore të BE-së. QKK gjithashtu mbështet projekte që mund të përfitojnë nga skemat e financimit evropian, duke siguruar koordinimin dhe përshtatjen me standardet ndërkombëtare.

B. BAZA LIGJORE

Kjo Rregullore mbështetet në ligjin nr. 8096, datë 21.03.1996 “Për Kinematografinë” (i ndryshuar), si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; Konventën e Bernës “Për Mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artistike”, miratuar me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 487, datë 09.03.1993, ligjin nr. 109/2021 “Për Ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Koproduksionin Kinematografik (e rishikuar), Rotterdam, 30.01.2017; ligjin nr. 35/2016 “Për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura me to” (i ndryshuar); Komunikatë e Komisionit për ndihmën shtetërore për filmat dhe veprat e tjera audiovizive (Tekst me rëndësi për ZEE) (2013/C 332/01).

KREU - II- STRUKTURAT PËRBËRËSE

A. KËSHILLAT DHE KOMISIONET

Pranë QKK-së funksionojnë këto këshilla dhe komisione:

- i. Këshillat e Miratimit të Projekteve;
- ii. Komisioni Financiar;
- iii. Komisioni i Vizionimit;
- iv. Komisioni i Monitorimit të Projekteve;
- v. Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve.

A.1 KËSHILLAT E MIRATIMIT TË PROJEKTEVE

1. Këshillat Miratues të Projekteve (KMP), janë organizma kolegiale, jofunksionale, jashtë strukturës administrative të QKK-së, të cilat formohen me kandidatë të propozuar dhe

E.C.

zgjedhur nga shoqatat e kineastëve të njohura nga QKK.

1. KMP-të gëzojnë autonomi të plotë për vlerësimin e projekteve kinematografike.
2. KMP-të kanë mandat ligjor 2-vjeçar. Veprimtaria e tyre shpërblehet me honorar, sipas përcaktimit të bërë në aktet nënligjore në fuqi.
3. KMP-të janë të organizuara si më poshtë:
 - KMP e Projekteve të Filmit artistik;
 - KMP e Projekteve të filmit dokumentar, të animuar dhe projekte të ndryshme kinematografike.

A.1.1 KRIJIMI I KMP-ve DHE PËRBËRJA E TYRE

1. Procedura për krijimin e KMP-ve fillon me njoftimin e bërë nga Kryetari i QKK-së.
2. Propozimet për anëtarë të KMP-ve bëhen nga shoqatat e kineastëve, që ushtrojnë veprimtarinë konform ligjit nr. 8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë", të ndryshuar dhe janë njohur nga QKK.
3. Kandidatët e propozuar nga shoqatat e kineastëve duhet të jenë personalitete të kinematografisë dhe audiovizualit, shtetas shqiptarë nga Republika e Shqipërisë, shqiptarë nga Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia, Greqia, Italia, Kroacia dhe diaspora. Kandidatët e propozuar, duhet të jenë:
 - a. Skenaristë;
 - b. Regjisorë;
 - c. Producentë;
 - d. Aktorë;
 - e. Kritikë arti/Estetë/Filozofë.
4. Secila shoqatë e kineastëve propozon nga 2 (dy) anëtarë të KMP-ve. QKK organizon një short për përbërjen e secilës KMP si dhe caktimin e 2 (dy) anëtarëve rezervë të cilët do të angazhohen në rast të mbarimit të mandatit përpara afatit të një anëtari të zgjedhur të KMP-së.
5. Në mbledhjet e KMP-ve merr pjesë Kryetari i QKK-së, apo një përfaqësues i autorizuar prej tij, pa të drejtë vote.
6. KMP-të përbëhen nga 5-7 anëtarë.

A.1.2 FUNKSIONIMI I KMP-ve

1. Detyra kryesore e KMP-ve është vlerësimi i projekteve kinematografike nga pikëpamja artistike e ekonomike, si dhe përzgjedhja e projekteve mbi bazë meritokracie, duke garantuar përzgjedhjen e projekteve kinematografike që sigurojnë cilësinë, interesin kombëtar dhe miradministrimin e fondeve publike.
2. Anëtarët e KMP-ve mbajnë përgjegjësi ligjore për çdo vendim që marrin.

E. Ç.

3. Mbledhjet e KMP-ve kryhen me praninë fizike në ambientet e QKK-së, dhe në raste të veçanta në rrjet.
4. Në mbledhjen e parë, anëtarët e KMP-ve, kryejnë këto procedura:
 - a. zgjedhin Kryetarin e KMP-së me votim të hapur;
 - b. plotësojnë dhe nënshkruajnë:
 - i. deklaratën për shmangien e konfliktit të interesave në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.
 - ii. formularin e vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (i ndryshuar);
 - iii. kontratën e shërbimit;
 - iv. shqyrtojnë projekte kinematografike sipas rendit të ditës.
5. Kryetari i KMP-së, drejton mbledhjen, garanton zbatimin e ligjshmërisë, zbatimin e rregullave të etikës në komunikim ndërmjet pjesëmarrësve në mbledhje, si dhe marrjen e vendimeve të drejta në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Mbledhjet e KMP-ve organizohen nga QKK. Mbledhjet thirren nga Kryetari i QKK-së në bazë të kalendarit të thirrjeve të projekteve dhe sa herë të jetë e nevojshme.
7. Kryetari i QKK, përcakton datën, vendin dhe mënyrën e zhvillimit të mbledhjeve me njoftim administrativ.
8. Mbledhjet e KMP-ve, janë të vlefshme kur marrin pjesë 2/3 e anëtarëve.
9. KMP-të vlerësojnë me përparësi projektet që:
 - a. kanë siguruar paraprakisht një pjesë të financimit të veprës me fonde publike nga koproducentë vendas apo të huaj, sponsorë, fondacione, donatorë, kredi bankare, etj. Financimet duhet të vërtetohen me letër angazhimi zyrtare për konfirmimin nga enti publik ose privat ku të jenë të identifikuar qartë elementët e projektit (titulli, skenari, regjia, producenti, koproducenti dhe vlera e financimit);
 - b. kanë siguruar financime alternative përmes marrëveshjeve të parashitjeve dhe/ose parablerjeve me distributorë dhe difuzorë brenda dhe jashtë RSH.
10. KMP miraton projektet fituese me votim me pikë me fletë votimi të veçantë dhe secili anëtar plotëson fishën e leximit për secilin projekt të paraqitur. Fletët e votimit dhe fishat e leximit miratohen me vendim të posaçëm të Kryetarit të QKK-së.
11. Në vlerësimin e punës të tre autorëve skenarist, kompozitor dhe regjisor, si dhe të producentit, do t’i jepet prioritet dhe vlerësim me pikë filmave të mëparshëm që janë kualifikuar në konkurim zyrtar dhe seksione konkurruese në festivalet e akredituara nga FIAPF. Listen e festivaleve e gjeni në aneksin 1 të kësaj rregulloreje e cila mund të ndryshohet sipas përditësimeve të mundshme të FIAPF-së.

E.C.

Vlerësime me çmime apo përzgjedhje në konkurim të festivaleve për animacion të listuara në aneksin 1.

Vlerësime me çmime apo kualifikim në konkurim (sipas rendit alfabetik):

1. Academy Awards
2. Bafta
3. Cesar
4. David Di Donatello
5. European Film Academy Awards
6. Golden Globes
7. Goya

12. Në vlerësimin e projekteve do t'i jepet prioritet dhe vlerësim me pikë projekteve filmike që kanë realizuar paraprakisht zhvillimin e projektit, duke marrë mbështetje financiare, apo duke u kualifikuar në laboratorë të specializuara për këtë qëllim të njohura nga QKK të listuara në aneksin 1

A.1.3 SEZONI I THIRRJEVE PËR APLIKIME/PROJEKTE

Sezoni i thirrjeve për aplikime/projekte zhvillohet çdo vit dhe i referohet periudhës 6 mujore të hapjes së thirrjeve, gjatë së cilës Qendra Kombëtare e Kinematografisë (QKK) pranon dhe vlerëson kërkesat propozimet për financim ose mbështetje, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996 "Për Kinematografinë" (i ndryshuar), Statutit të QKK-së dhe Rregullores së Përgjithshme të Financimeve dhe Lejeve si dhe Rregullores të Brendshme të saj.

Afatet dhe Procedura e Thirrjeve

- Thirrjet mund të hapen një ose më shumë herë në vit, në varësi të fondeve dhe prioriteteve të QKK-së, në përputhje me Ligjin nr. 8096/1996 dhe aktet nënligjore përkatëse.
- Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e plotë brenda afatit të shpallur nga QKK, duke respektuar rregullat e përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të Financimeve dhe Lejeve të QKK.
- Para shqyrtimit nga Këshillat e Miratimit të Projekteve (KMP), projektet kalojnë fillimisht në Komisionin e Shqyrtimit Paraprak të Projekteve (KSHPP) për verifikimin e përputhshmërisë me kriteret administrative dhe ligjore të përcaktuara në aktet rregullatore të QKK-së.

A.1.4 PROCESI I VOTIMIT

1. Anëtarja i/e KMP, pasi lexon projektin e paraqitur për aplikim, plotëson individualisht fishën e leximit dhe fletën e votimit për secilin projekt të shqyrtuar, duke shprehur me shkrim, argumentat dhe vlerësimin e tij/saj profesional lidhur me projektin, të cilët duhet të jenë në përputhje me vlerësimin me pikë.

E.C.

2. Gjatë vlerësimit me pikë, anëtari/ja i/e KMP gjykon mbi informacionin që është depozituar në dosjen e aplikimit lidhur me përvojat, arritjet dhe vlerësimet e filmave të mëparshëm të komponentëve të vlerësimit (skenar, regji, muzikë, produksion, distribucion, difuzion etj).
3. Në përfundim të votimit, fletët e votimit administrohen në praninë e KMP-së nga Juristi i QKK-së, i cili kontrollon dhe verifikon anën formale të plotësimit të fletëve të votimit (plotësimi i secilit komponent të fletës së votimit, nënshkrimi i saj, etj).
4. Në prezencë të anëtarëve të KMP, Juristi i QKK lexon me zë të lartë secilën fletë votimi dhe fishë leximi, dhe bazuar në totalin e pikëve të grumbulluara bëhet renditja, nga projekti me pikët maksimale, deri tek projekti me pikët minimale. Kryetari i QKK, në konsultim me Grupin e Menaxhimit Strategjik të QKK (GMS), vendos për numrin e projekteve që do të përfitojnë mbështetjen financiare. Vendimmarrja bazohet në këto kritere:
 - a. Garancitë e suksesit të projekteve të vlerësuara me pikët më të larta;
 - b. Fondet që QKK ka në dispozicion për financimin e projekteve në konkurim.

KMP, në vendimin e tij, krahas titullit dhe të dhënave të secilit projekt, përcakton masën e financimit të tij, bazuar në ekspertizën e bërë nga Komisioni Financiar.

2. Anëtarët e KMP-ve nënshkruajnë proces-verbalin dhe vendimin përfundimtar të mbledhjes
3. Vendimi i KMP dhe Kryetarit të QKK publikohen në faqen zyrtare të internetit të QKK-së dhe në Buletinin Zyrtar.
4. Drejtoria e Projekteve ka detyrimin t'i përcjellë producentëve të projekteve të papërzgjedhura, informacion lidhur me:
 - i. Rezultatit e votimit;
 - ii. Fishat e leximit të anëtarëve të KMP-ve, emrat e të cilëve nuk do të jenë të identifikuar.

A.1.5 TË DREJTAT E ANËTARIT TË KMP

Anëtari/ja i/e KMP-së gëzon këto të drejta gjatë ushtrimit të mandatit:

1. Merr njoftim të rregullt për detajet si: data, vendi dhe rendi i ditës së mbledhjes që do të zhvillohet.
2. Shpreh mendimin e tij për çështjet që shtrohen për diskutim.
3. Shprehet me fishë leximi dhe votim me pikë për secilin projekt që shqyrton, në pavarësi të plotë dhe me integritet profesional.
4. Disponon materialet e projekteve që do të shqyrtojnë, të paktën 10 ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes.
5. Paguhet për pjesëmarrjen në mbledhje, sipas akteve nënligjore në fuqi, në varësi të llojit të projekteve që shqyrtohen.
6. Shpenzimet e akomodimit, udhëtimit dhe ushqimit për anëtarët e KMP që jetojnë jashtë Tiranës apo territorit të Republikës së Shqipërisë përballohen nga QKK.

A.1.6 DETYRAT E ANËTARIT/ES TË KMP

E.C.

Anëtari/ja i/e KMP ka këto detyrime gjatë ushtrimit të mandatit:

1. Merr pjesë rregullisht në mbledhjet e KMP.
2. Respekton rregullat e etikës të përcaktuara në Kodin e Sjelljes dhe Etikës së QKK-së në komunikim gjatë mbledhjeve të KMP, si dhe në vendimmarrjen e tij.
3. Dëshmon integritet dhe profesionalizëm në vendimmarrje.
4. Paraqet fishën e leximit të plotësuar e cila duhet të jetë në përputhje me vlerësimin me pikë, për vendimmarrjen e tij për çdo projekt.
5. Nënshkruan nën përgjegjësi të plotë deklaratën për shmangien e konfliktit të interesave në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar dhe njofton me shkrim Kryetarin e QKK, në rast se evidenton apo konstaton se vendimmarrja e tij përbën konflikt interesi.
5. Lexon dhe njeh në mënyrë të detajuar dokumentacionin e secilit projekt konkurrues.
6. Sheh filmin/at paraardhës të regjisorit/es dhe të producentit/es aplikues/e, (për këtë qëllim në dokumentacionin e çdo projekti gjendet lidhje e filmit në Vimeo, shoqëruar me fjalëkalimin përkatës).
7. Nuk ka të drejtë të aplikojë, ose të jetë pjesë e projekteve konkurruese gjatë periudhës kohore 2 (dy) vjeçare të ushtrimit të mandatit si anëtar i KMP. Ky përcaktim është i vlefshëm edhe në rastin kur anëtari/ja i/e KMP jep dorëheqjen e parakohshme nga mandati i tij/saj.
8. Në rastin e përfundimit të parakohshëm të mandatit të një anëtari/e të KMP (pavarësisht nga arsyeja), anëtari/ja zëvendësohet/e i/e nënshtrohet këtij rregulli, si dhe gëzon të gjitha të drejtat dhe detyrimet si anëtar/e i/e KMP, deri në përfundim të mandatit të KMP.
9. Në rast se verifikohet marrja e vendimeve në kushtet e konfliktit të interesave, QKK është e detyruar që të veprojë sipas përcaktimeve ligjore të parashikuara për këto raste.

A.1.7 PËRFUNDIMI I PARAKOHSHËM I MANDATIT

Anëtari/ja i/e KMP, largohet nga ky funksion përpara përfundimit të mandatit në rastet kur:

1. Jep dorëheqje me shkrim për arsye personale.
2. Bëhet i paaftë për arsye shëndetësore.
3. Vërtetohet, nga institucionet kompetente, se ka marrë vendim, në kushtet e konfliktit të interesave.
4. Kryen veprime që janë në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Kodin e Sjelljes dhe Etikës së QKK, të cilat pengojnë mbarëvajtjen dhe zhvillimin normal të mbledhjeve të KMP.
5. Dënohet nga gjykata me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.
6. Nuk merr pjesë në 2 (dy) mbledhje të njëpasnjëshme

A.2 KOMISIONI I SHQYRTIMIT PARAPRAK TË PROJEKTEVE

E.C.

Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve (KShPP) ka për detyrë kontrollin administrativ dhe ligjor të aplikimeve, për të verifikuar përputhshmërinë e tyre me kriteret dhe dokumentacionin e kërkuar nga Rregullorja e Përgjithshme e Mbështetjes Financiare dhe Lejeve. KShPP mund të skualifikojë një projekt vetëm për mangësi dokumentacioni ose mungesë të kriterëve të detyrueshme, por nuk merr vendime mbi vlerësimin artistik të projektit. Projektet që kalojnë këtë fazë i referohen për shqyrtim Këshillave të Miratimit të Projekteve (KMP).

1. Komisioni i Shqyrtimit Paraprak të Projekteve përbëhet nga:
 - i. Drejtori i Drejtorisë së Projekteve
 - ii. Specialisti i Projekteve
 - iii. Juristi i QKK-së
2. Komisioni ka për detyrë shqyrtimin dhe verifikimin administrativ dhe ligjor të projekteve kinematografike që depozitohen për konkurim. Ai zhvillon punën e tij duke ndjekur procedurën e mëposhtme:
 - i. Projektet e paraqitura për konkurim përmes e-mail-it zyrtar shkarkohen brenda 5 (pesë) ditë pune nga data e përfundimit të afatit të përcaktuar për depozitimin e projekteve.
 - ii. Verifikohet dokumentacioni i kërkuar dhe ai i paraqitur nga secili producent sipas thirrjes dhe projektit aplikues.
 - iii. Nëse është e nevojshme, Komisioni mund të kërkojë dokumentacion shtesë për të sqaruar ose plotësuar elementë të aplikimit. Mospërmbushja e kësaj kërkesë sjell automatikisht skualifikimin e projektit.
- iv. Komisioni harton një procesverbal për projektet e depozituara, ku përcaktohen:
 - Projektet e depozituara, me të gjithë elementët (skenar/regji/producent) për secilën kategori;
 - Projektet që skualifikohen për shkak të mangësive në dokumentacion, mosplotësimin të kriterëve të vendosura për konkurim ose penaliteteve të mbartura nga kontratat e mëparshme (nëse ka);
 - Projektet që kualifikohen për konkurim.
 - Pas nënshkrimit të procesverbalit, Komisioni i bën me dije secilit aplikues vendimin duke përshkruar arsyet përkatëse sipas përcaktimeve ligjore të parashikuara për këto raste.

A.3 KOMISIONI I MONITORIMIT TË PROJEKTEVE

1. Komisioni i Monitorimit të Projekteve, përbëhet nga:
 - i. Drejtori i Drejtorisë së Projekteve
 - ii. Specialisti Jurist
 - iii. Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve të Brendëshme.
2. Komisioni ka për detyrë të monitorojë projektet kinematografike dhe audiovizuale të

E.C.

- mbështetura financiarisht nga QKK në të gjitha fazat deri në përfundim, për të siguruar miradministrimin e fondeve publike dhe realizimin e suksesshëm të tyre.
3. Çdo anëtar i komisionit ka detyrë të inspektojë/monitorojë produksionet (sipas kompetencave/detyrës që ushtron), me qëllim miradministrimin e fondeve publike dhe realizimit me sukses të projekteve kinematografike dhe audiovizuale të mbështetura nga QKK.
 4. Komisioni, brenda hapësirave që lejon sipërmarrja e lirë e tregut të punës (kërkesë-ofertë), monitoron veçanërisht trajtimin e ekipit teknik të filmit, kryesisht lidhur me garantimin e etikës dhe kushteve normale të punës, nga ana e producentëve.
 5. Në përfundim të çdo projekti kinematografik, komisioni shqyrton dokumentacionin administrativ e financiar dhe harton një relacion përmbledhës, duke evidentuar ecurinë e projektit, si dhe problematikat e realizimit të tij, (në rast se vërehen).
 6. Komisioni i relatton me shkrim Kryetarit të QKK-së, kur konstaton keqadministrim, shpërdorim, apo abuzim me fondet e akorduara dhe propozon masa administrative konkrete ndaj shtëpisë kinematografike.
 7. Komisioni i Monitorimit të Projekteve kryen një analizë vjetore të të gjitha projekteve të financuara dhe evidenton ato që rrezikojnë të mos përmbyllen brenda afatit të kontratës për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme (forcë madhore) dhe ndarjen nga jeta të pjesëmarrësve kryesor të projektit. Ky vlerësim bazohet në shqyrtimin e dokumentacionit administrativ dhe financiar të projektit. Forcë madhore përkufizohet çdo ngjarje e paparashikueshme dhe e pakontrollueshme që pengon përmbylljen e detyrimeve kontraktuale, përfshirë: fatkeqësi natyrore (tërmete, përmbytje, zjarre), kriza të papritura politike ose ekonomike, konflikte të armatosura, pandemi, greva të përgjithshme, apo vendime administrative që ndikojnë drejtpërdrejt në ekzekutimin e projektit.
 8. Në rastet kur një projekt vlerësohet si në rrezik për shkak të forcave të jashtëzakonshme dhe/apo ndarjes nga jeta të pjesëmarrësve kryesor të projektit, komisioni paraqet një raport te Kryetari i QKK-së, duke propozuar mbështetje shtesë, nëse ajo konsiderohet e justifikuar, ose penalitete në të kundërtën.
 9. Kufiri maksimal për mbështetje shtesë është si më poshtë:
 - Filma artistikë me metrazh të gjatë – deri në 2,000,000 lekë.
 - Filma dokumentarë dhe të animuar – deri në 1,000,000 lekë.
 - Seriale – deri në 500,000 lekë.
 - Filma me metrazh të shkurtër – deri në 200,000 lekë.
 10. Pas raportimit nga komisioni, Kryetari vendos kalimin për vendimmarrje në KMP në rastet e mbështetjes shtesë.
 11. Producentët që përfitojnë financim shtesë janë të detyruar të përfundojnë projektin brenda 4 muajve nga miratimi i mbështetjes Komisioni monitoron që fondet e dhëna për mbështetje shtesë përdoren sipas qëllimit të miratuar.
 12. Producentët e projekteve të financuara dorëzojnë raporte mujore për progresin dhe përdorimin e fondeve, të cilat shqyrtohen nga komisioni.

E.Ç.

13. Për rastet kur një producent nuk e përmbush afatin 4-mujor, komisioni propozon penalitete, si:
 - i. Kthimin e fondeve të marra.
 - ii. Përfshirjen nga mbështetja financiare e QKK-së për projekte të ardhshme.
14. Komisioni përgatit një raport vjetor mbi përdorimin e financimeve shtesë, për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie. Ky raport i dorëzohet Kryetarit të QKK-së

A.4 KOMISIONI FINANCIAR

1. Komisioni Financiar, është organizëm jo funksional, me mandat 2-vjeçar, i cili emërohet nga Kryetari i QKK dhe përbëhet nga tre anëtarë/e:
 - i. Drejtori i Drejtorisë së Projekteve (QKK)
 - ii. Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme (QKK).
 - iii. Përfaqësues i Drejtorisë Ekonomike të Ministrisë përgjegjëse për Kulturën.
2. Komisioni Financiar ka këto kompetenca kryesore:
 - i. Vlerëson nga ana financiare projektet e paraqitura në konkurim, duke bërë përlllogaritje në bazë të tarifave të financimit, të hartuara konform procedurave dhe të miratuara nga Grupi i Punës i ngritur për këtë qëllim dhe Drejtoria e Projekteve të QKK-së.
 - ii. Miraton ose refuzon kërkesën për ndryshim/e zërash në preventivin e miratuar nga KF për secilën fazë të projekteve. Kërkesa e shtëpisë kinematografike duhet të jetë e argumentuar dhe e justifikuar. Komisioni ka të drejtë të mos e miratojë, në rast se kërkohen ndryshime të cilat në buxhetin përfundimtar janë deklaruar se mbulohen nga koproducenti/tët.
 - iii. Mbikëqyr dokumentacionin financiar të shpenzimeve të bëra për fondin buxhetor të projekteve të financuara, si dhe afatet e parashikuara në kontratën e financimit.
 - iv. Merr vendim për njohjen ose jo të shpenzimeve të kryera prej shtëpive kinematografike.
 - v. Komisioni njeh vetëm shpenzimet në periudhën e financimit.
 - vi. Miraton situacionin përfundimtar të realizimit të projektit dhe informon Kryetarin e QKK.
3. Vendimi i Komisionit Financiar është i vlefshëm kur në mbledhje marrin pjesë jo më pak se 2 (dy) anëtarë të tij. Vendimi i Komisionit merret me shumicë votash.
4. Mbledhjet e Komisionit Financiar evidentohen në një procesverbal, i cili hartohet në tre kopje.

A.5 KOMISIONI I VIZIONIMIT

1. Komisioni i Vizionimit është organizëm jo funksional, me afat 2-vjeçar dhe përbëhet nga tre anëtarë:
 - i. Përfaqësues i Ministrisë përgjegjëse për Kulturën.
 - ii. Drejtori i Drejtorisë përgjegjëse për Projektet (QKK).
 - iii. Specialisti Jurist (QKK)
2. Kryetari i Komisionit të Vizionimit zgjidhet nga anëtarët e Komisionit.
3. Komisioni i Vizionimit pajis me Leje Qarkullimi veprat filmike, që paraqiten nga distributorët

E. Ç.

për t'u pajisur me Leje Qarkullimi. Komisioni i Vizionimit mbledhet sa herë është e nevojshme.

4. Distributori i paraqet Komisionit të Vizionimit këto dokumente:
 - i. Kërkesën për të kategorizuar dhe qarkulluar filmin
 - ii. Kopjen e filmit (të përkthyer dhe subtitruar në gjuhën shqipe), në suport elektronik bashkëkohor përmes Vimeo (ose platformave të ngjashme) me fjalëkalim, i shkarkueshëm dhe pa watermark për arkivim.
 - iii. Marrëveshje ose autorizim me shkrim nga producenti, që vërteton të drejtën e distributorit për shpërndarjen e filmit (në rast se distributori dhe producenti janë subjekte të ndryshme);
 - iv. Kopja e filmit të paraqitur duhet të jetë e njëjtë me variantin që do të distribuohet;
 - v. Përveç filmave produksione me financim të QKK, për të gjithë filmat e tjerë distributori duhet të paguajë tarifën e vizionimit, e cila është e përcaktuar me udhëzim të Ministrisë përgjegjëse për Financat.
5. Vizionimi i filmit, duhet të bëhet brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pune nga paraqitja e dokumenteve, e koordinuar me datën e caktuar nga distributori për premierën e shfaqjes së filmit. Distributori duhet të paraqesë kërkesën së paku 15 ditë pune para parashikimit të premierës zyrtare.
6. Vendimi i Komisionit është i vlefshëm kur në vizionim marrin pjesë jo më pak se 2 (dy) anëtarë të tij. Vendimi i Komisionit merret me shumicë votash. Komisioni voton vetëm “pro” dhe “kundër”.
7. Kur vepra filmike e paraqitur nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi, Komisioni i Vizionimit, nuk i pajis distributorët me leje qarkullimi të filmit.
8. Vendimet miratuese të Komisionit kategorizohen:
 - i. Kategoria “A”, kur filmi lejohet të shfaqet dhe mund të shikohet nga të gjitha moshat. Në këtë kategori hyjnë filmat që forcojnë idealet e humanizmit dhe kanë karakter edukues, përfshirë dhe fëmijët.
 - ii. Kategoria “B”, kur filmi lejohet të shfaqet dhe mund të shikohet vetëm nga shtetasit mbi 14 vjeç. Në këtë kategori hyjnë filmat, të cilët nuk janë në kontradiktë me parimet dhe normat universale të moralit, por ka kuadro të veçanta me përmbajtje erotike ose dhune.
 - iii. Kategoria “C”, kur filmi lejohet të shfaqet dhe mund të shikohet vetëm nga shtetasit mbi 18 vjeç.
9. Për vendimin e Komisionit, distributori njoftohet me shkrim. Në rast se distributori nuk është dakort me vendimin e Komisionit, ai ka të drejtë të bëjë ankimim administrativ.
10. Komisioni i Vizionimit ka të drejtë t'i rekomandojë Kryetarit të QKK-së, mospajisjen me leje qarkullimi, për të gjithë ata filma që bien ndesh me dispozitat ligjore të Republikës së Shqipërisë që kanë të bëjnë me:
 - a. cënim të nderit dhe prestigjit të historisë dhe të kombit shqiptar.
 - b. kanë përmbajtje apo nxitin ndjenja urrejtje, etnike, ksenofobie, raciste, terrorizëm, etj.

E. G.

- c. kultivojnë ideologji fundamentaliste, etj.
11. Vendimi i Komisionit konfirmohet nga Kryetari i QKK, i cili mbi bazën e relatimit të bërë nga Komisioni i Vizionimit, nënshkruan Lejen e Qarkullimit të filmit, e cila përmban:
- a. Numrin e lejes në regjistrin kinematografik dhe audiovizual të QKK.
 - b. Titullin e filmit në gjuhën shqipe.
 - c. Titullin e filmit në gjuhën origjinale të produksionit.
 - d. Kategorinë e filmit.
 - e. Nënshkrimin e Kryetarit dhe vula e Qendrës.
 - f. Leja publikohet në Buletinin Zyrtar të Kinematografisë

B. ORGANIZIMI I BRENDSHËM I PERSONELIT

B.1 DETYRA TË PËRGJITHSHME

1. Punonjësit e QKK, ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë dhe për zbatim të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, akteve të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e administratës publike, si dhe Kodin e Sjelljes dhe Etikës së QKK.
2. Zbatojnë me korrektësi detyrat e përcaktuara në këtë rregullore, respektojnë hierarkinë dhe raportojnë rregullisht te eprorët e tyre.
3. Respektojnë orarin e punës sipas akteve nënligjore në fuqi dhe marrin pjesë në trajnime profesionale të organizuara nga QKK të paktën një herë në vit për të rritur aftësitë dhe përgjegjshmërinë.
4. Përpara se të marrin detyrën, punonjësit verifikojnë nëse kanë konflikt interesi ose papajtueshmëri që bien në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.
5. Sigurojnë transparencë në punën e tyre dhe komunikim me publikun sipas politikave të QKK-së.

B.2 STRUKTURA E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË PERSONELIT

1. Struktura e organizimit të brendshëm të personelit të QKK-së është si më poshtë:

Kryetari

Drejtoria e Projekteve

- Drejtori/ja i Projekteve
- Specialisti/ja Jurist
- Specialisti/ja për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Shtypin
- Specialisti/ja për Projektet
- Arkivisti/ja

Spektori i Shërbimeve të Brendshme

E.C.

- Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme
- Specialist Finance
- Specialist Mbështetës

B.2.1 KRYETARI

B. 2.1.1 Kryetari

Kryetari është organi drejtues i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK), i emëruar nga Këshilli i Ministrave, dhe ka kompeteca të plota në vendimmarrje, drejtimi, menaxhim, organizim, dhe përfaqësim të institucionit në përputhje me Ligjin Nr. 8096/1996 "Për Kinematografinë"(i ndryshuar), Statutin e QKK-së, dhe legjislacionin në fuqi.

Kompetencat e Kryetarit përfshijnë, por nuk kufizohen si më poshtë:

1. Kryen të gjitha veprimet për drejtimin e QKK-së.
2. Mban marrëdhënie me institucionet publike dhe private, vendase dhe të huaja. Mban lidhje me Ministrin/en përgjegjës për kulturën, për hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në fushën e kinematografisë.
3. Përcakton dhe drejton veprimtarinë e strukturës administrative të QKK-së në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996 "Për Kinematografinë", të ndryshuar.
4. Merr vendime, si dhe të japë udhëzime për mënyrën e vënies në zbatim të programit vjetor të QKK-së.
5. Nxjerr urdhra të brendshëm me qëllim përmbushjen e funksioneve të njohura nga ligji dhe Statuti i QKK-së.
6. Merr pjesë në mbledhjet e Këshillave të Miratimit të Projekteve pa të drejtë vote.
7. Merr vendime që lidhen me çështje organizative apo financiare, sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
8. Drejton Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), si dhe udhëheq punën për menaxhimin e riskut dhe minimizimin e tij.
9. Miraton vendimet e Këshillave Miratues të Projekteve duke patur të drejtën të rikthejë një herë vendimin e KMP-ve, bashkëngjitur me arsyet përkatëse.
10. Pezullon përkohësisht ose në mënyrë përfundimtare veprimtarinë e shtëpive kinematografike, apo distributorëve, kur strukturat e QKK vërejnë dhe i parashtrojnë me shkrim shkelje ligjore nga ana e tyre.
11. Emëron Komisionet dhe Këshillat që ushtrojnë aktivitetin në QKK.
12. Autorizon të drejtën e kryerjes së veprimeve të veçanta apo kategori veprimesh të një ose disa punonjësve të QKK-së.
13. Emëron dhe liron nga detyra punonjësit e QKK-së, si dhe jep masa administrative ndaj tyre, sipas përcaktimeve ligjore.
14. Pajis me Leje Qarkullimi filmat e finsncuar nga QKK si dhe të gjithë filmat shqiptarë apo të huaj që qarkullojnë në territorin e Shqipërisë, bazuar në vendimet e Komisionit të Vizionimit.
15. Ushtron detyrën e Nepunësit Autorizues (NA).
16. Mbështet pjesëmarrjen në festivale ndërkombëtare dhe tregje filmi për promovimin e kinematografisë shqiptare.
17. Rishikon dhe miraton kërkesat për lejet e personelit.

E.G.

- Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve të Brenshme
- Specialist Finance
- Specialist Mbështetës

B.2.1 KRYETARI

B. 2.1.1 Kryetari

Kryetari është organi drejtues i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK), i emëruar nga Këshilli i Ministrave, dhe ka kompeteca të plota në vendimmarrje, drejtimi, menaxhim, organizim, dhe përfaqësim të institucionit në përputhje me Ligjin Nr. 8096/1996 "Për Kinematografinë"(i ndryshuar), Statutin e QKK-së, dhe legjislacionin në fuqi.

Kompetencat e Kryetarit përfshijnë, por nuk kufizohen si më poshtë:

1. Kryen të gjitha veprimet për drejtimin e QKK-së.
2. Mban marrëdhënie me institucionet publike dhe private, vendase dhe të huaja. Mban lidhje me Ministrin/en përgjegjës për kulturën, për hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në fushën e kinematografisë.
3. Përcakton dhe drejton veprimtarinë e strukturës administrative të QKK-së në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996 "Për Kinematografinë", të ndryshuar.
4. Merr vendime, si dhe të japë udhëzime për mënyrën e vënies në zbatim të programit vjetor të QKK-së.
5. Nxjerr urdhra të brendshëm me qëllim përmbushjen e funksioneve të njohura nga ligji dhe Statuti i QKK-së.
6. Merr pjesë në mbledhjet e Këshillave të Miratimit të Projekteve pa të drejtë vote.
7. Merr vendime që lidhen me çështje organizative apo financiare, sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
8. Drejton Grupin e Menaxhimit Strategik (GMS), si dhe udhëheq punën për menaxhimin e riskut dhe minimizimin e tij.
9. Miraton vendimet e Këshillave Miratues të Projekteve duke patur të drejtën të rikthejë një herë vendimin e KMP-ve, bashkëngjitur me arsyet përkatëse.
10. Pezullon përkohësisht ose në mënyrë përfundimtare veprimtarinë e shtëpive kinematografike, apo distributorëve, kur strukturat e QKK vërejnë dhe i parashtrojnë me shkrim shkelje ligjore nga ana e tyre.
11. Emëron Komisionet dhe Këshillat që ushtrojnë aktivitetin në QKK.
12. Autorizon të drejtën e kryerjes së veprimeve të veçanta apo kategori veprimesh të një ose disa punonjësve të QKK-së.
13. Emëron dhe liron nga detyra punonjësit e QKK-së, si dhe jep masa administrative ndaj tyre, sipas përcaktimeve ligjore.
14. Pajis me Leje Qarkullimi filmat e finsncuar nga QKK si dhe të gjithë filmat shqiptarë apo të huaj që qarkullojnë në territorin e Shqipërisë, bazuar në vendimet e Komisionit të Vizionimit.
15. Ushtron detyrën e Nepunësit Autorizues (NA).
16. Mbështet pjesëmarrjen në festivale ndërkombëtare dhe tregje filmi për promovimin e kinematografisë shqiptare.
17. Rishikon dhe miraton kërkesat për lejet e personelit.

E.C.

18. Propozon tarifat për regjistrimin e producentëve dhe distributorëve që miratohen nga Ministria përgjegjëse për financat.
19. Përfaqëson QKK në marrëdhëniet me institucionet ndërkombëtare simotra, rajonale apo evropiane, fondacione filmi, etj.
20. Përfaqëson QKK në gjykatë, personalisht ose nëpërmjet autorizimit, në çdo konflikt gjyqësor ku QKK është palë.

B.2.2 DREJTORIA E PROJEKTEVE

Drejtoria e projekteve përbëhet nga:

B.2.2.1 DREJTORI I DREJTORISË SË PROJEKTEVE

Drejtori i Drejtorisë së Projekteve kryen funksionet dhe detyrat e mëposhtme:

1. Drejtori i Projekteve koordinon dhe mbikëqyr zbatimin e vendimeve të Këshillave të Miratimit të Projekteve (KMP) dhe Kryetarit të QKK-së, me Specialistin Jurist për çështjet ligjore dhe administrative të projekteve.
2. Mbikëqyr prezantimin e projekteve në konkurim para KMP-së, duke deleguar detyrat operative të Specialistit i Projekteve kur është e nevojshme.
3. Mbikëqyr monitorimin e zbatimit të projekteve sipas planeve kalendarike dhe kontratave, duke bashkërenduar detyrat operative me Specialistin e Projekteve dhe Specialistin Jurist.
4. Monitoron detyrimet ligjore të producentëve për qarkullimin e filmave të financuar nga QKK.
5. Ka të drejtën të kërkojë dokumentacion shtesë nga aplikantët për sqarimin e elementeve të projekteve.
6. Është pjesë në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
7. Propozon penaltete për producentët që shkelin detyrimet kontraktuale, duke i paraqitur ato Kryetarit me raport të detajuar.
8. Mban kontakte të vazhdueshme me producentët për të ndjekur ecurinë e produksioneve dhe për të adresuar çdo problematikë.
9. Mban kontakte me institucionet simotra, në nivel të pushtetit vendor Shqiptar dhe rajonal, profesionist të lirë dhe furnitorë dhe merr informacion për çmimet, tarifat, nivelet e pagesave të ekipit teknik në produksionin e filmit.
10. Mbi bazën e statistikave dhe informacionit të mbledhur mbi çmimet, tarifat dhe pagesat e ekipeve teknike, harton një plan tarifash për shqyrtim bashkë me grupin e punës. Planet e tarifave rishikohen të paktën çdo dy vjet për të reflektuar ndryshimet e tregut dhe kostove të produksionit.
11. Miraton paraprakisht kontratat e financimit për projektet kinematografike, duke u siguruar për përputhshmërinë me vendimet e KMP-së dhe Kryetarit, përpara nënshkrimit përfundimtar nga Kryetari.

E.Ç.

12. Raporton rregullisht te Kryetari dhe KMP-ja mbi progresin e projekteve, përfshirë analiza të detajuara mbi zbatimin financiar dhe artistik, si dhe çdo çështje ligjore ose shkelje të kontratave.
13. Miraton propozimet për lejet e personelit.
14. Mbikëqyr disiplinën dhe efikasitetin e personelit, duke deleguar detyra operative (p.sh., miratimin e lejeve) te specialisti jurist.
15. Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga Kryetari me urdhër ose vendim të veçantë, në përputhje me objektivat e QKK-së.

B.2.2.2 SPECIALIST JURIST

Specialisti Jurist kryen funksionet dhe detyrat e mëposhtme:

1. Kontrollon zbatimin e kërkesave ligjore në të gjitha aktivitetet e QKK-së.
2. Njofton Kryetarin për çdo çështje ligjore ose shqetësim në bazë të rasteve.
3. Përgatit akte ligjore dhe nënligjore, si dhe akte administrative që rregullojnë aktivitetet e QKK-së.
4. Përgatit vendime për Këshillin e Miratimit të Projekteve (KMP) dhe Kryetarin lidhur me miratimin e financimit të projekteve.
5. Harton kontrata financimi për projektet kinematografike pas miratimit nga KMP dhe Kryetari.
6. Harton kontrata difuzioni dhe kontrata bashkëpunimi me persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj.
7. Administron dosjet fizike të projekteve kinematografike deri në përfundimin e tyre administrative dhe financiare, duke përfshirë dorëzimin e veprës.
8. Administron sistemet SQDNE dhe AMS për shërbimet në rrjet të QKK-së në e-Albania.
9. Koordinon procedurat e regjistrimit të personave fizikë dhe juridikë që kanë për objekt veprimtarinë e produksionit dhe/ose distribucionit të filmave.
10. Siguron përputhshmërinë ligjore dhe administrative të të gjitha proceseve të sipërpërmendura.
11. Përgatit materiale dhe përfaqëson QKK-në në gjykatë me autorizim të posaçëm nga Kryetari në çdo konflikt gjyqësor ku QKK është palë.
12. Menaxhon korrespondencën ligjore të QKK-së me institucione të tjera.
13. Merr pjesë në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).
14. Kontrollon përmblyshjen e detyrimeve të pranuar kontraktore dhe atyre të parashikuara sipas ligjit dhe rregulloreve në fuqi të QKK-së të projekteve me financim nga QKK-ja dhe të enteve të tjera të kontraktuara.
15. Administron dosjet e stafit të QKK-së.
16. Raporton çdo problem ose mospërputhje te Drejtori i Projekteve.
17. Përgatit dokumentacionin për procedurat e prokurimeve publike.
18. Monitoron dhe raporton ndryshimet ligjore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar që mund të ndikojnë në veprimtarinë e QKK-së, duke përfshirë legjislacionin për të drejtat e autorit dhe

E.C

rregulloret e Bashkimit Evropian për kinematografinë, dhe informon Kryetarin dhe Drejtorin e Projekteve për çdo ndikim të mundshëm.

19. Kryen çdo detyrë tjetër të caktuar me urdhër ose vendim të veçantë nga Kryetari i QKK-së.

B.2.2.3 SPECIALIST I PROJEKTEVE

Specialisti i projekteve kryen funksionet dhe detyrat e mëposhtme:

1. Përgatit materialet për Komisionin e Shqyrtimit Paraprak të Projekteve.
2. Përgatit materiale të ndryshme informative mbi projektet në konkurim, për t'ia paraqitur Këshillave Miratues të Projekteve dhe Kryetarit të QKK.
3. Mban kontakte, njofton producentët për thirrjet për aplikime dhe informacione me interes për aktivitetet e tyre.
4. Menaxhon aktivitetet e organizuara nga QKK.
5. Përgatit korrespondencën e QKK me institucione të tjera lidhur me projektet kinematografike.
6. Përgatit dokumentacionin që i përcillet KMP-ve. Të përgatisë informacione dhe statistika për aktivitetin e QKK.
7. Mban një bazë të dhënash dixhitale me informacione mbi projektet e financuara nga QKK-ja, duke përfshirë detaje mbi përparimin, financimin dhe rezultatet e tyre, për të lehtësuar raportimin dhe analizën e performancës së projekteve.
8. Kryen çdo detyrë tjetër, për të cilën ngarkohet me urdhër/vendim të veçantë nga Kryetari i QKK.

B.2.2.4 SPECIALIST PËR MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE SHTYPIN

Specialisti kryen funksionet dhe detyrat e mëposhtme:

1. Mban marrëdhënie me institucionet homologe, organizatat ndërkombëtare dhe partnerët vendas e të huaj, duke identifikuar dhe monitoruar mundësi si festivale filmi, shfaqje, workshope, programe financimi dhe ngjarje të tjera me interes për kinematografinë.
2. Informon dhe mbështet producentët e regjistruar në QKK për mundësitë e pjesëmarrjes në aktivitete ndërkombëtare, duke i udhëzuar për aplikime, promovim dhe marrëdhëniet me median.
3. Promovon QKK-në dhe projektet e saj të financuara përmes bashkëpunimit me median dhe partnerët, duke përdorur rrjetet sociale dhe ngjarjet për të rritur vizibilitetin dhe imazhin pozitiv.
4. Koordinon pjesëmarrjen e QKK-së dhe producentëve në aktivitete ndërkombëtare, duke përgatitur materiale promovuese dhe duke zbatuar marrëveshjet e bashkëpunimit.
5. Përkthen materialet që vijnë nga institucione homologe dhe anasjelltas, korrespondencën me ambasadat e huaja si dhe me organizmat ndërkombëtare që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vendin tonë

E.C.

6. Organizon dhe koordinon përfaqësimin e QKK-së në pavione ndërkombëtare si Cannes dhe Berlinale, duke bashkëpunuar ngushtë me Drejtorin e projekteve për të siguruar një prezencë të koordinuar.
7. Raporton te Drejtoria e Projekteve dhe Kryetari mbi marrëdhëniet me partnerët, mundësitë e identifikuar dhe përfitimet për QKK-në.
8. Mbledh dhe analizon të dhëna nga shfaqjet, premierat dhe aktivitetet e financuara për të krijuar materiale promovuese dhe raporte mbi sukseset dhe ndikimin.
9. Ndjek zbatimin e aktiviteteve të organizuara nga QKK ose të financuara nga QKK-ja.
10. Harton një strategji vjetore për komunikimin dhe promovimin ndërkombëtar të kinematografisë shqiptare në bashkëpunim me Kryetarin dhe Drejtorinë e Projekteve.
11. Kryen çdo detyrë tjetër, për të cilën ngarkohet me urdhër/vendim të veçantë nga Kryetari i QKK.

B.2.2.5 ARKIVIST

Arkivisti kryen funksionet dhe detyrat e mëposhtme:

1. Njeh dhe zbaton ligjin Nr. 9154, date 6.11.2003 "Për arkivat".
2. Bashkërendon punën për mbylljen e dosjeve të hapura sipas Pasqyrës Emërtuese të Çeljes së Dosjeve.
3. Bën përpunimin tekniko-shkencor dhe ekspertizën e vlerës së ruajtjes së dokumenteve.
4. Krijon njësitë e ruajtjes (dosjet) për çdo praktike, brenda nje viti kalendarik, duke filluar me nr. 1 të dosjes për çdo vit të ri.
5. Plotëson të gjitha të dhënat në kapakun e dosjes që nga sektori, nr. dosjes, viti, titulli i dosjes dhe afatet e ruajtjes së dosjes, etj.
6. Administron librin e protokollit dhe zbaton të gjitha rregullat për plotësimin e tij;
7. Kryen dixhitalizimin e regjistrit të protokollit duke bashkërenduar me Specialistin IT për implementimin teknik.
8. Organizon punën për shfrytëzimin e dokumenteve për plotësimin e kërkesave operative, duke hartuar për këtë qëllim edhe një procesverbal të daljes nga Arkivi të dokumenteve për shfrytëzim.
9. Harton dokumenta të ndryshme informative si inventarë, katalogë, skeda, udhërrëfyes, etj, sipas Ligjit të Arkivave në fuqi.
10. Merr në dorëzim dhe arkivon dokumentacionin e projekteve kinematografike (dosjet e projekteve), pasi ato mbyllën konform procedurave në fuqi.
11. Përgatit praktikën për krijimin e Komisionit të Ekspertizës dhe harton listën e asgjësimit të dokumenteve që kanë plotësuar afatin e ruajtjes, duke hartuar edhe listën konkrete të ruajtjes së dokumenteve.

E. Ç.

12. Kryen arkivimin e kopjeve (dokumentacion dhe kopje filmi) të paraqitura nga distributorët për t'u pajisur me Leje Qarkullimi në territorin e RSH.
13. Kryen çdo detyrë tjetër, për të cilën ngarkohet me urdhër/vendim të veçantë nga Kryetari i QKK.

B.2.3 SEKTORI I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

B.2.3.1 PËRGJEGJËS I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme kryen funksionet dhe detyrat e mëposhtme:

1. Zbatojë ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në fushën ekonomike e financiare që gjejnë zbatim në QKK dhe ndjek realizimin e shpenzimeve të nevojshme për funksionimin e QKK.
2. Harton dokumentacionin e nevojshëm për ekzekutimin e shpenzimeve të ndryshme që nevojitet të kryejë QKK.
3. Harton dokumentacionin e nevojshëm për ekzekutimin nga pikëpamja financiare për projektet e miratuara nga KMP-të dhe Kryetari sipas kontratave të financimit të lidhura me producentët.
4. Monitoron dhe informon Kryetarin (nga i cili ka varësi direkte) për limitet mujore për të gjitha shpenzimet e kryera.
5. Bën pjesë në Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), si dhe kryen detyra të ndryshme për menaxhimin e riskut dhe minimizimin e tij kur autorizohet me shkrim nga Kryetari rast pas rasti.
6. Harton projekt-buxhetin e QKK, si dhe detajon zërat e fondeve në çdo fillim viti dhe ia përcjell për miratim Kryetarit.
7. Ndjek realizimin e pagesave dhe detyrimeve të producentëve dhe distributorëve ndaj QKK.
8. Llogarit fondin e pagave për çdo muaj dhe reflekton ndryshimet e mundshme që mund të ndodhin, pas marrjes së listëprezencës së miratuar nga eprori.
9. Mban evidencat dhe përgjigjet në çdo kohë për nivelin e shpenzimeve administrative të QKK.
10. Mban lidhje me Ministrinë përgjegjëse për financat dhe organet e tjera për realizimin e zërave të buxhetit të planifikuar të QKK.
11. Mban lidhje të vazhdueshme me Degën e Thesarit Tiranë për rakordimin e shpenzimeve dhe të ardhurave të realizuara.
12. Harton korrespondencën e nevojshme me institucione të ndryshme në fushën e financave.
13. Ndan dhe monitoron detyrat e punonjësve që ka në varësi, si dhe raporton tek titullari për çdo problem që mbulon sektori.
14. Kryen çdo detyrë tjetër, për të cilën ngarkohet me urdhër/vendim të veçantë nga Kryetari i QKK.

E.C.

B.2.3.2 SPECIALIST FINANCE

Specialisti i financës kryen funksionet dhe detyrat e mëposhtme:

1. Mban lidhje të vazhdueshme dhe asiston në rast nevojë shtëpitë filmike për probleme sqarime financiare.
2. Mban lidhje me specialistin e degës së thesarit për përcjelljen e dokumentacionit dhe për ekzekutimin e urdhër-xhirimeve.
3. Mban lidhje me bankat dhe ndjek ecurinë e veprimeve për të lehtësuar procedurat e financimeve.
4. Merr pjesë në hartimin e planeve të tarifave të QKK për financimin e projekteve kinematografike.
5. Ndjek realizimin e shpenzimeve administrative të QKK, duke mbajtur evidencat përkatëse, në zbatim të akteve ligjore që gjejnë zbatim në këtë sektor.
6. Mbikëqyr arkëtimin e të ardhurave nga subjektet që kontraktojnë me QKK për distribucionin e filmave shqiptarë, produksione të para viteve '90 dhe të ardhurave të tjera që krijohen nga distribucioni dhe qarkullimi i filmave.
7. Mban listprezencen e stafit të QKK.
8. Kryen çdo detyrë tjetër, për të cilën ngarkohet me urdhër/vendim të veçantë nga Kryetari i QKK.

B.2.3.3 SPECIALIST MBËSHTETËS

1. Administron dhe përditëson faqen zyrtare të internetit dhe rrjeteve sociale të QKK-së.
2. Administron pajisjet dhe/ose aparaturat e vizionimit të filmave të QKK, si dhe realizon shfaqjen e filmave për Komisionin e Vizionimit.
3. Vendos në dispozicion materialet filmike që disponon në kuadër të aktiviteteve që organizohet prej QKK-së, si dhe përgatit materiale grafike për promovimin e këtyre aktiviteteve;
4. I jep asistencën e nevojshme teknike zyrës së protokoll-arkivës lidhur me digjitalizimin e dokumentacionit.
5. Merr të gjitha masat e nevojshme teknike për garantimin e kushteve normale të punës së punonjësve të QKK.
6. Kryen procedurat teknike për regjistrimin e personave fizikë dhe juridikë që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre ushtrimin e aktivitetit produksion dhe/ose distribucion filmi, difuzor, duke siguruar funksionalitetin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e platformave digjiitale të përdorura për këto procese.
7. Mirëmban rrjetin dhe pajisjet kompjuterike të QKK, evidenton gjendjen dhe kushtet teknike të tyre dhe kur vërehen nevoja për shërbime raporton tek përgjegjësi i sektorit.
8. Specialisti është përgjegjës për të kërkuar dhe publikuar njoftime në Buletinin Zyrtar të Kinematografisë, faqen zyrtare të internetit dhe rrjetet sociale të QKK-së, sipas nevojës së

E.Ç.

Drejtorisë së Projekteve. Njoftimet mund të përfshijnë vendimet e KMP-së, thirrjet për aplikime dhe informacione të tjera me interes publik.

9. Kryen çdo detyrë tjetër, për të cilën ngarkohet me urdhër/vendim të veçantë nga Kryetari i QKK.

KREU - III- BULETINI ZYRTAR I KINEMATOGRAFISË

1. Buletini Zyrtar i Kinematografisë (BZK) është botimi zyrtar e Kinematografisë i cili botohet periodikisht çdo 3 muaj dhe përmban të gjitha aktet rregullatore dhe vendimet e nxjerra nga QKK.
2. BZK përgatitet, publikohet dhe përditësohet nga Drejtoria e Projekteve dhe Sektori i Shërbimeve të Brendshme dhe publikohet në faqen zyrtare të QKK-së.

KREU - IV- HYRJANË FUQI

1. Rregullorja Nr.163 Prot, Datë 22. 05. 2024 shfuqizohet.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi datën e nënshkrimit të saj, dhe botohet në Buletinin Zyrtar të Kinematografisë.

E.C.

ANEKSI 1

Festivalet e akredituara nga FIAPF (sipas rendit alfabetik) si më poshtë:

1. Antalya Golden Orange Film Festival
2. Bengaluru International Film Festival
3. Berlin International Film Festival
4. Busan International Film Festival
5. Cairo International Film Festival
6. Cannes International Film Festival
7. Cinedays
8. Cinema Jove
9. Clermont-Ferrand International Short Film Festival
10. Eurasia International Film Festival
11. Fajr International Film Festival
12. Fantastic Fest
13. Festival De Cine Global Dominicano
14. Gijon International Film Festival
15. Goa - International Film Festival of India
16. International Film Festival of Kerala
17. International Short Film Festival Oberhausen
18. Jio Mami Mumbai Film Festival
19. Karlovy Vary International Film Festival
20. Kitzbühel Film Festival
21. Kolkata International Film Festival
22. Krakow International Film Festival
23. Locarno Film Festival
24. Malaga Festival
25. Mar Del Plata International Film Festival
26. Molodist - Kyiv International Film Festival
27. Mostra De Valencia - Cinema Del Mediterrani
28. Noir In Film Festival
29. Rome Film Fest
30. San Sebastian International Film Festival
31. Shanghai International Film Festival
32. Sitges International Fantastic Film Festival of Catalunya
33. Sofia International Film Festival
34. Sydney Film Festival
35. Tallinn Black Nights Film Festival
36. Tampere Film Festival
37. Tokyo International Film Festival
38. Torino Film Festival

E. Ç.

39. Toronto International Film Festival
40. Transilvania International Film Festival
41. Venice International Film Festival
42. Viennale International Film Festival
43. Warsaw Film Festival
44. Zinebi - International Festival of Documentary and Short Film of Bilbao

Fesivalet e animacionit sipas <https://vurchel.com/> dhe si më poshtë:

1. Annecy International Animated Film Festival - Annecy - France
2. Animafest Zagreb - Zagreb - Croatia
3. Ottawa International Animation Film Festival - Ottawa - Canada
4. Stuttgart Festival of Animated Film - Stuttgart - Germany
5. Holland Animation Film Festival - Utrecht - Netherlands
6. Hiroshima - Animation Season - Japan
7. Anima Mundi - Rio de Janeiro - Brazil
8. Fantoche International Animation Film Festival Switzerland
9. Animac - Lleida - Spain
10. Anifilm - Trebon - Czech Republic
11. Anima, the Brussels International Animation Film Festival Brussels
12. London International Animation Festival United Kingdom (UK)
13. Melbourne International Animation Festival Australia
14. Fredrikstad Animation Festival Norway
15. Insomnia International Animation Film Festival Russian Federation
16. Kaboom Animation Festival Netherlands
17. Fest Anča International Animation Festival Slovakia
18. Bucheon International Animation Festival South Korea
19. MONSTRA | Lisbon Animation Festival Portugal
20. CINANIMA International Animated Film Festival Portugal
21. ANIMA, Córdoba International Animation Festival Argentina
22. Animasyros International Animation Festival Greece
23. International Animation Festival CHILEMONOS Chile

Laboratorët për zhvillim si më poshtë:

1. Cinekid Script LAB
2. CineLink | Sarajevo Film Festival
3. Creative Europe - Media Program (script development fund)
4. Equinoxe Europe International Screenwriters' Workshops
5. LIM | Less is More
6. MFI Script 2 Film - Mediterranean Film Institute

E.G.

7. MIDPOINT Institute
8. Script Station | Berlinale Talents
9. ScripTeast - Independent Film Foundation (Eastern Europe countries)
10. ScriptLab | TorinoFilmLab
11. Talents Labs | Berlinale Talents
12. The Residence - Cinéfondation
13. WHEN EAST MEETS WEST – Trieste

E.g.